



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 793/2 Prot.

Tiranë, më 04.05.2026

V E N D I M

Nr. 113, Datë 04.05.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 99, datë 24.04.2026 të z. E. B., kundër Shkollës “Woodrow Wilson International School”, në të cilën pretendon diskriminim të fëmijës së tij S. B., për shkak të “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ndër të tjera, informon se: *Në cilësinë e prindit të nxënëses S. B., e regjistruar pranë Woodrow Wilson International School, klasa e 9, paraqes këtë ankesë zyrtare lidhur me veprimet dhe komunikimet e fundit të institucionit në fjalë. Gjatë gjithë periudhës disa-vjeçare të ndjekjes së shkollës (rreth 5 vite), në çdo komunikim me stafin pedagogjik dhe shërbimin psiko-social (sipas bisedës që bëmë me urdhrin e psikologut, psikologia e shkollës E. Ç., nuk ka licencë për ushtrim profesioni), më janë dhënë vetëm vlerësime pozitive për ecurinë akademike dhe gjendjen e përgjithshme të fëmijës. Në asnjë moment nuk jam njoftuar për shqetësime të natyrës emocionale, të sjelljes apo të shëndetit mendor.*

Në mënyrë të papritur, në datën 17 Prill 2026, më është vënë në dispozicion një letër rekomandimi nga punonjësi social i shkollës për vlerësim psiko-social të fëmijës, pa u shoqëruar me evidenca konkrete apo histori të dokumentuar të shqetësimeve të pretenduara.

Më tej, në një komunikim të fundit zyrtar nga shkolla data 21 Prill, më është kërkuar që brenda një afati prej 3 ditësh fëmija të ndihet nga një specialist dhe të vendoset kontakt i menjëhershëm midis specialistit dhe shkollës. Gjithashtu, është komunikuar se, në rast mosandjekjeje të kësaj procedure brenda afatit të përcaktuar, shkolla nuk do të vijojë ofrimin e shërbimit arsimor.

Në vijim të kësaj situatë, kam zhvilluar një konsultë me një psikolog të licencuar në institucion shtetëror, i cili, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe shpjegimeve përkatëse, ka mbajtur një qëndrim kategorikisht kundërshtues ndaj mënyrës së ndjekur dhe formës së komunikimit nga ana e institucionit arsimor.

Sipas vlerësimit të tij profesional, përmbajtja dhe formulimi i kërkesës së shkollës janë në kundërshtim me standardet bazë të praktikës profesionale në fushën e shëndetit mendor dhe nuk mbështeten në një proces të rregullt, të dokumentuar dhe të justifikuar vlerësimi. Në mënyrë të veçantë, është theksuar se vendosja e një afati prej 3 ditësh për realizimin e një vlerësimi të tillë është jashtëzakonisht jashtë çdo kuptimi profesional dhe praktik, duke e bërë të pamundur zhvillimin e një procesi serioz, të plotë dhe të përgjegjshëm.

Ai ka theksuar gjithashtu se një qasje e tillë, e paargumentuar dhe e vonuar, e cila nuk merr në konsideratë historikun dhe kontekstin e plotë të fëmijës, rrezikon të prodhojë një trajtim të padrejtë dhe me elemente të mundshëm diskriminimi. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se vajza ime është nxënëse me bursë pranë Shkolla Wilson që prej klasës së 5-të, përfutuar mbi bazën e meritës dhe rezultateve të saj të shkëlqyera akademike. Ajo ka ruajtur në mënyrë të vazhdueshme një mesatare shumë të lartë prej 9.8, çka provon qartë përkushtimin, aftësinë dhe integrimin e saj të plotë në jetën shkollore.

Në këtë kontekst, çdo trajtim i diferencuar, negativ apo tendencioz ndaj saj, përbën jo vetëm cenim të parimit të barazisë dhe meritokracisë në arsim, por ngre gjithashtu dyshime të arsyeshme për shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë parimet e mbrojtjes nga diskriminimi dhe garantimit të një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët në institucionet arsimore.

Është domethënëse që këto sjellje dhe qëndrime problematike kanë filluar menjëherë pasi është bërë e ditur se familja jonë ka vendosur të largohet nga kjo shkollë në vitin e ardhshëm akademik. Ky fakt krijon një lidhje të drejtpërdrejtë shkak-pasojë dhe ngre dyshime serioze për trajtim të padrejtë me natyrë hakmarrëse apo ndëshkuese, në kundërshtim të hapur me standardet ligjore dhe etike që duhet të udhëheqin institucionet arsimore.

Më tej, veprimet e ndërmarra, përfshirë përpjekjet për të ndikuar në marrëdhëniet e saj shoqërore dhe për ta izoluar nga bashkëmoshatarët, mund të kualifikohen si forma të presionit psikologjik dhe cenim i mirëqenies emocionale të fëmijës. Këto veprime, të cilat kanë filluar të vërehen gjatë tre ditëve të fundit, përfshijnë edhe ndarje të qëllimshme nga shoqet, ndryshime të projekteve që ishin zhvilluar në bashkëpunim me to për një periudhë të gjatë kohe, ndryshime në pozicionin e bankave, si dhe moslejimin e kontakteve apo qëndrimit së bashku gjatë orarit mësimor. Këto elemente bien ndesh me detyrimin ligjor të institucionit arsimor për të garantuar mbrojtjen e

interesit më të lartë të fëmijës, si dhe për të parandaluar çdo formë bullizmi, diskriminimi apo trajtimi degradues brenda mjedisit shkollor.

Sipas bisedës që zhvillova me psikologun shtetëror dhe më pas në konsultim me Urdhrin e Psikologëve, u evidentuan problemet e mëposhtme:

- *Dokumenti nuk shoqërohet me asnjë raport, procesverbal apo praktikë të ndjekur që të vërtetojë pretendimet e psikologut të shkollës, pavarësisht insistimit të prindit që këto materiale të vireshin në dispozicion, duke marrë parasysh edhe faktin se shkolla disponon kamera sigurie që mund të verifikojnë lehtësisht pretendimet në fjalë. Kërkesa është refuzuar me arsyetimin se materialet janë konfidenciale.*
- *Gjatë një periudhe prej 5 vitesh nuk është regjistruar asnjë ankesë, dhe nuk u është komunikuar prindërve asnjë shqetësim apo problem në lidhje me shëndetin mendor të vajzës. Gjithashtu, nuk është realizuar asnjëherë bisedë apo vlerësim psikologjik me nxënësen lidhur me problemet e pretenduara nga shkolla.*
- *Shkolla kërkon detyrimisht që fëmija brenda 3 diteve të kryejë një konsultë me psikologun, ndërkohë që psikologia shtetërore sqaroi se një kërkesë e tillë mund të bëhet vetëm nga prindi, me pëlqimin e fëmijës dhe vetëm nëse prindi e vlerëson të nevojshme. Në asnjë rast nuk mund të ketë detyrim të drejtpërdrejtë nga shkolla pa një praktikë të dokumentuar dhe të ndjekur në kohë.*
- *Shkolla kërkon që psikologu shtetëror të mbajë komunikim me psikologun e shkollës, gjë që tejkalon kompetencat e përcaktuara, pasi psikologu shtetëror informon dhe komunikon vetëm me prindin dhe jo me palë të tjera pa autorizim përkatës.*

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, duke marrë në konsideratë jo vetëm faktet konkrete, por edhe kuadrin ligjor përkatës, dhe të ndërmerren masat e nevojshme për ndalimin e menjëhershëm të këtyre praktikave dhe rikthimin e një mjedisi të sigurt, të drejtë dhe dinjitoz për vajzën e ankuesit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 99 Regj., datë 24.04.2026, të paraqitur nga z. E. B., u konstatua se ankesa, nga pikëpamja formale, nuk përmbushte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, lidhur me përmbajtjen minimale të nevojshme për inicimin e procedurës së shqyrtimit të saj.

Në këtë kuadër, me qëllim garantimin e të drejtës së palës për plotësimin e ankesës dhe zhvillimin e një procesi administrativ të rregullt, me e-mail të datës 28.04.2026, nga ana e institucionit të Komisionerit iu kërkua ankuesit plotësimi i informacionit dhe dokumentacionit përkatës, përkatësisht: *sqarime të detajuara mbi shkakun e pretenduar të diskriminimit, duke identifikuar*

qartë karakteristikën personale që pretendohet se ka shërbyer si bazë e trajtimit të padrejtë, të shoqëruara me fakte dhe prova konkrete; sqarim mbi lidhjen shkakësore ndërmjet këtij shkak dhe trajtimit të pretenduar diskriminues, duke evidentuar pasojat konkrete të pësuar; informacion mbi adresimin e mëparshëm të çështjes pranë institucioneve të tjera, së bashku me kopje të ankesave dhe përgjigjeve përkatëse; si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës që gjykohej i nevojshëm për shqyrtimin e saj.

Në vijim të këtij komunikimi, me e-mail të datës 29.04.2026, z. E. B., ka paraqitur deklarin e tij për tërheqje nga ankesa nr. 99 Regj., datë 24.04.2026, duke u shprehur se, pas zhvillimeve të fundit në shkollë, ishte informuar se fëmija i tij do të vijonte normalisht dhe pa shqetësime procesin mësimor deri në përfundim të vitit shkollor, dhe se, në këto kushte të reja faktike, konsideronte të zgjidhur çështjen objekt ankimi. Gjithashtu, ai ka shprehur falënderim për angazhimin e institucionit dhe mirëkuptimin e treguar në trajtimin e rastit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.99 Regj., datë 24.04.2026, të paraqitur nga z. E. B., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA